




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Date: 17.03.2023

Nr.02/150

Ne bazë të dispozitave nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), në mbështetje të dispozitave të nenit 90, dhe nenit 91, të Ligjit Nr. 04/L-027, për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, në pajtim me nenin 54 e Statutit të Komunës së Shtimes 01 Nr: 06/1636, të datës 3. 9. 2008, dhe në zbatim të neneve dhe dispozitave që kanë të bëjnë me aktivitetet komisionit lokal të Rregullores për Metodologjinë Vlerësimi të Dëmeve nga Fatkeqësitë Tjera Nr. 17/2015, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për formimin e Komisionit Lokal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Themelohet Komisioni Lokal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Komisioni formohet në këtë përbërje:

1. Albulenë Emini-sekretare
2. Bajram Gashi-anëtar
3. Bashkim Ahmeti-anëtar
4. Adelina Ismajli-anëtar
5. Tafil Hasani-anëtar
6. Fatmir Rexhepi-anëtar
7. Hamide Hoxha-anëtar

3. Komisioni emërohet për periudhën (2) dy vjeçare.
4. Organi lokal përgjegjës për fushën e menaxhimit emergjent siguron kushtet e nevojshme për punë të papënguar të komisioneve nga paragrafi 2 i nenit 8 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë mjetet e matjes, fotoaparate, formularët e paraparë me këtë rregullore, hapësirën e punës ku komisioni do të kryej punët e tij profesionale, administrative dhe punët e tjera.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.

Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org

<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

5. Detyrat e komisionit lokal janë si në vijim:

- a. Organizon numrine nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision;
- b. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vetë komisioni lokal
- c. Cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve
- d. Kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje
- e. Bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe ju Ofron ndihmën e nevojshme profesionale
- f. Përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtimin
- g. Raportin e miratuar nga asambleja komunale ia dorëzon Agjencisë në afat prej 17 ditëve nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror
- h. Propozon prioritetet për shfrytëzimin e mjeteve të ndara për sanimin dhe mënjanimin e pasojave që kanë ndodh nga fatkeqësitë dhe për këtë e njofton kryetarin e Komunës
- i. Kryen punë ekipore, profesionale dhe të pa ndikuar
- j. Mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës
- k. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet sipas legjislacionit në fuqi.

Iu dërgohet.

Drejtorisë së Shërbimeve Publike
Anëtarve të komisionit
Arkivit të komunës

